



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport
Mbledhja nr.68
Prishtinë, më 7.11.2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi
Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyçi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Shinik.

Mungoi Sërgjan Popoviq.

Përfaqësues të ftuar: Xhevdet Smakiqi ekspert i angazhuar i Komisionit.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues të Demokracia Plus, KDI-së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Nait Hasani tha se Projektligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, është shqyrtuar dhe miratuar në parim në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2015.

Lidhur me këtë projektligj Komisioni ka angazhuar ekspertë me qëllim që ligji të jetë më i zbatueshëm në praktikë.

Anëtarët e Komisionit filluan me shqyrtimin nen për nen të Projektligjit, dhe u propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 2 riformulohet te referenca e Direktivës.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 1.8 fshihet teksti “janë të gjithë”.

Amendamenti 3

Neni 3, paragrafi 2 fjala ”pikën” zëvendësohet me fjalën ”paragrafin”.

Amendamenti 4

Neni 4, nënparagrafi 1.7 pas fjalës “sportiv” shtohet teksti” dhe terrenit sportiv”.

Amendamenti 5

Neni 4 nënparagrafi 1.10 riformulohet si vijon:

1.10. Futja dhe përdorimi i mjeteve piroteknike, mjeteve te forta dhe mjeteve tjera në objektet sportive përdorimi i të cilave mund të shkaktojnë pasiguri të pjesëmarrësve në ngjarjes sportive.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që të vazhdohet me amendamentimin e Projektligjit në mbledhjen e radhës.

3. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pat diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani